

FJALA E DEPUTETIT SAIMIR HASALLA

E HËNË 31 TETOR 2022

Të nderuar kolegë,

Reforma Administrative-Territoriale e vitit 2014 është pa diskutim një nga reformat më të rëndësishme të ndërmarra ndonjëherë për qeverisjen vendore. Gjatë kohës kur diskutohej në komision kjo reformë, në vitin 2014, unë i kam ndjekur nga afër zhvillimet e punimeve të atij komisioni. Ai komision që në fillim u ngrit mbi bazën e një vizioni të qartë dhe vendosi objektiva të qarta për hartimin e kësaj reforme. Pa diskutim, këto objektiva herë-herë ishin edhe mjaft ambicioze. Dhe megjithëse të tilla sot, 7 vjet më pas, pranohet nga të gjithë ne që në përgjithësi ato janë arritur me sukses. Suksesi dhe impakti pozitiv i kësaj reforme është i dukshëm dhe i prekshëm në të gjitha njësitë e krijuara nga kjo reformë. Zbatimi i kësaj reforme nisi në vitin 2015, kur edhe unë pata fatin ta implemetoj ndër të parët, dhe të kisha drejtimin e një prej 61 bashkive të vendit, atë të bashkisë së Peqinit.

Gjatë zbatimit në terren të kësaj reforme, në çdo ditë që kalonte kuptoheshin më mirë përfitimet nga kjo reformë. Rritja e kapaciteteve për çdo bashki, krijimi i mundësive të reja, si dhe i mundësive më të mëdha për krijimin e investimeve, të bënin të kuptojë qartë përfitimet nga kjo reformë, kundrejt ndarjes së kaluar me 385 njësi. Në atë kohë kjo reformë ishte mëse e domosdoshme për t'u dhënë një frymëmarrje të re këtyre njësive, si dhe hapësira më të mëdha vetëqeverisëse në shërbim të komunitetit. Rritja e nivelit të performancës së këtyre njësive, si dhe asaj të administratës së tyre është përmirësuar ndjeshëm, por, pa diskutim, ky është një proces i vazhdueshëm që kërkon nga të gjithë ne, por edhe nga faktorët dhe aktorët ndërkombëtarë, mbështetje.

Arritjet kryesore të kësaj reforme janë të shumta, por ndër kryesoret do të veçoja:

Të ardhurat e krijuara nga këto njësi të qeverisjes vendore janë dukshëm shumë herë më të mëdha se të ardhurat e krijuara në periudhën para implementimit të kësaj reforme;

Shuma e grantit të pakushtëzuar është rritur dhe vazhdon të rritet nga viti në vit;

Qeverisja vendore ka mundur rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve, sidomos në menaxhimin e mbetjeve të ngurta, furnizimit me ujë, por edhe reformën e fundit të ujit, planifikimit urban dhe investime të tjera të mëdha.

Kalimi i kompetencave të reja këtyre bashkive, si arsimi parashkollor, shërbimi zjarrfikës, vadija, kullimi, pyjet e të tjera, tregojnë edhe një herë suksesin e kësaj reforme nëpërmjet përmirësimit të këtyre shërbimeve. Krijimi i sporteve me një ndalesë u dha mundësi të gjithë qytetarëve, edhe pse në zonat më të largëta të bashkisë, të kishin akses për çdo kërkesë të tyre në një zyrë të vetme. Krijimi i 61 bashkive u shoqërua edhe me rritjen e eficiencës në ofrimin e shërbimeve. Me ndarjen e vjetër, njësitë vendore me numër popullsie të vogël kishin burime njerëzore mjaft të kufizuara, gjë që krijonte edhe pamundësi në ushtrimin e disa funksioneve apo shërbimeve të ngarkuara nga ligji, mungesë aftësie për mbledhjen e taksave dhe varësi totale nga transferta e pakushtëzuar. Ndaj, copëzimi edhe një herë i këtyre njësiteve do të ishte i dëmshëm dhe aspak efikas.

A mund të bëjmë vlerësimin përfundimtar të kësaj reforme? Pa diskutim që jo, sepse kanë kaluar vetëm 7 vjet nga implementimi i saj, madje mandati i dytë i këtyre bashkive ka qenë atipik. Të gjithë ne biem dakord që kjo reformë territoriale dhe ndarja në 61 bashki është tashmë një histori suksesi. Propozimi për ta copëzuar dhe fragmentarizuar hartën do të ishte një dështim dhe kthim pas në kohë. Copëzimi në ngastra të vogla i bashkive ekzistuese do të ulte funksionalitetin e tyre. Si mund të mendohet një performancë më e mirë e bashkisë së Peqinit duke e copëzuar akoma më shumë? Absolutisht jo. Kohë më parë kjo bashki ka qenë pjesë e zvogëlimit të territorit, gjë e cila ka shkaktuar mjaft probleme me funksionalitetin e saj, largimin e shumë institucioneve nga kjo bashki dhe deri në vënien në dyshim të ekzistencës të saj.

Bashkia, mbi të gjitha, ka si kriter edhe lidhjet tradicionale dhe historike të zonës. Ne nuk mund t'i trajtojmë sot bashkitë si çifligje politike dhe për interesa personale të propozojmë ndarje të re territoriale për të krijuar sa më shumë njësi, për të bërë qokat tona të rastit. Ndaj, unë personalisht jam kundër çdo ndarjeje të re territoriale. Pa diskutim që reforma ka nevojë për përmirësime, por këto janë të gjitha në kuadrin e shtimit të kompetencave të bashkive, rritjes së decentralizimit, pra, mbi të gjitha, plotësimin e kuadrit ligjor. Faleminderit!